

02/09/2019

## **Fjeti më Zotin Hirësia e Tij, Nikoni, Arqiepiskop i Bostonit, i New England dhe i Arqidioqezës Shqiptare**



Në datën 1 shtator 2019 fjeti më Zotin Hirësia e Tij, Nikoni, Arqiepiskop i Bostonit, i New England dhe i Arqidioqezës Shqiptare.

Lindi në vitin 1945 në Nju Jork, në një familje të përkushtuar orthodhokse me origjinë shqiptare, me shumë kontribute për Kishën. Përfundoi studimet në Seminarin e ShënVladimirit më 1966 dhe u dorëzua dhjakon e më pas në prift në vitin 1969. Ai shërbeu me devotshmëri për shumë vjet në dy kisha të Arqidioqezës Shqiptare, në kishën e Shën Nikollës, në Southbridge, Massachusetts, dhe në kishën e Shën Thomait, në Farmington Hills, Michigan.

Në maj të vitit 2002, u dorëzua Episkop i Baltimorës dhe ndihmës i Mitropolitit Theodhos.

Në vitin 2003 u caktua Episkop i Arqidioqezës Shqiptare të OCA, dhe në tetor të vitit 2003 Sinodi i kësaj kishe e zgjodhi Episkop të Bostonit. Ai shërbeu edhe si administrator i dioqezës së New England. Në vitin 2005 mori nga Mitropoliti Herman titullin Episkop i Bostonit, i New England dhe i Arqidioqezës Shqiptare.

Në maj të vitit 2012 u ngrit në rangun e Arqiepiskopit.

Arqiepiskopi Nikon i ruajti gjithmonë të forta lidhjet me origjinën e tij. Familja e tij ishte nga Boboshtica e Korçës dhe i vëllai, atë Artur Liolini, është Kryekancelar i Arqidioqezës Shqiptare në Boston.

Të dy bashkë, atë Artur Liolin dhe Hirësi Nikoni, mirëpritën Kryepiskopin Anastas me rastin e 100-vjetorit të Kishës së Shën Gjergjit në Boston. Ata janë shprehur shpesh herë në media për arritjet e pakrahasueshme të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe kontributin e jashtëzakonshëm të Kryepiskopit Anastas. Hirësia e Tij Nikoni ishte i pranishëm në hapjen e dyerve dhe në përrurimin e Katedrales “Ngjallja e Krishtit”, në Tiranë, kur bëri edhe disa vizita, si në Manastirin e Shën Vlashit etj.

I përjetshëm kujtimi!

- [Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)